

**Situata e mungesës së  
energjisë elektrike:**

# **Ndërprerjet me rotacion**

**Çfarë duhet të marr  
parasysh?**

Një bashkëpunim i



 swisspower

**Diese Broschüre ist auch in Deutsch erhältlich.**

**Cette brochure est également disponible en français.**

**Il presente opuscolo è disponibile anche in italiano.**

**This brochure is also available in English.**

**Este folleto también está disponible en español.**

**Esta brochura também está disponível em português.**

**Ova brošura dostupna je i na srpskom jeziku.**

**Bu broşür Türkçe olarak da mevcuttur.**

**Informacion  
i përgjithshëm**

**Në parim, mungesa e energjisë mund të ndodhë në çdo kohë. Rreziku është real dhe i madh, sidomos në dimër. Faktorë të ndryshëm që mund të ndodhin njëkohësisht ose njëri pas tjetrit, mund të çojnë në një situatë mungese të energjisë.**

**Për shkak të krizës aktuale energjetike dhe furnizimit jo më të sigurt me energji si pasojë e sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës rreziku i rrjetit të furnizimit duhet vlerësuar si më i lartë.**

**Nëse furnizimi me energji elektrike nuk garantohet më, Këshilli Federal do të marrë masa: kursime, ndalime përdorimi, kuota dhe fikje të rrjetit rajonal për disa orë.**

**Kjo broshurë ka për qëllim planifikimin individual të furnizimit. Prandaj, ju lutemi ta ruani broshurën.**

## **Nëse ka mungesë të furnizimit me energji elektrike, Këshilli Federal mund të vendosë për masa të ndryshme – në varësi të ashpërsisë së gjendjes së mungesës:**

- Këshilli Federal i bën një apel për kursime popullatës.
- Këshilli Federal e ndalon përdorimin e pajisjeve dhe sistemeve të caktuara.
- Këshilli Federal i detyron konsumatorët e mëdhenj të energjisë elektrike të ulin konsumin e tyre të energjisë elektrike me një sasi të caktuar Ulja e përqindjes (kuotës).
- Nëse këto masa nuk kanë efektin e nevojshëm, Këshilli Federal do të urdhërojë mbylljen ciklike të rrjetit për disa orë si masë e fundit e mundshme. Kjo do të thotë që të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike do të alternonin mes ndërprerjes së energjisë elektrike dhe më pas të pasurit përsëri energji elektrike.

**Kjo broshurë shtjellon masa e fundit: stakimi me rotacion i rrjetit.**

## **Çfarë janë stakimet me rotacion të rrjetit?**

Stakimet me rotacion janë stakime të planifikuara të rrjetit, gjatë të cilave zonat individuale dhe konsumatorët e lidhur me to shkëputen nga furnizimi me energji elektrike për një periudhë të caktuar kohore. Kjo do të thotë se energjia elektrike do të jetë e disponueshme vetëm në intervale të rregullta dhe në zona të caktuara. Skenarët e mëposhtëm janë të mundshëm:

- **4 orë energji elektrike, 4 orë pa energji elektrike, 4 orë energji elektrike etj.**
- **12 orë energji elektrike, 4 orë pa energji elektrike, 4 orë pa energji elektrike, 12 orë energji elektrike etj. Në këtë skenar, ka një afat ditor prej 4 orësh gjatë të cilit e gjithë Zvicra furnizohet me energji elektrike.**

## **Kur do të ndodhin stakimet me rotacion të rrjetit?**

Nëse kërkesa për energji elektrike është më e madhe se sasia e energjisë elektrike të prodhuar, rrjeti elektrik mund të stakohet ("s'ka energji elektrike"). Nëse masat e tjera nuk janë të mjaftueshme për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet furnizimit dhe kërkesës për energji elektrike, Këshilli Federal mund të urdhërojë fikjen e rrjetit. Kjo bëhet vetëm si një masë e fundit për të parandaluar një kolaps total të rrjetit të energjisë.

## **Si mund të informohem se kur do të më ndërpritet furnizimi me energji elektrike?**

Këshilli Federal do të japë në kohë informacion në lidhje me ndërprerjet në një konferencë për shtyp. Më pas do të mësoni nga operatori lokal i rrjetit të shpërndarjes se në çfarë ore dhe në cilën frekuencë nuk do të ketë energji elektrike në zonën tuaj të banimit.

**Si mund të  
përgatitem  
që tani?**

## Merrni furnizime rezervë të (Kluger Rat – Notvorrat):

- Mblidhni rezerva ushqimore disaditore. Kini parasysh se disa ushqime që nuk kanë nevojë për frigorifer si dhe që mund të konsumohen edhe të ftohta e pa u gatuar (oriz, prodhime brumi, musli, peksimadhe, ushqime të konservuara, kafe, qumësht UHT, fruta të thata etj.).
- Nëse gjithsesi dëshironi të përgatisni një vakt të ngrohtë, ekziston alternativa e furnelave të kampingut, një Fondue-Rechaud apo një skarë me gaz për të ngrohur vaktet dhe ujin. Në rastet e përdorimit të pajisjeve të gatimit apo ngrohjes me zjarr të hapur, kini parasysh që të siguronit ajrosjen e duhur (rrezik helmimi me monoksid karboni).
- Nëse duhet të kujdeseni për foshnjat, fëmijët e vegjël ose të afërmit e sëmurë, është me vend që gjatë fazave me energji elektrike, si masë paraprake, të ngrohni ushqimin dhe/ose të zieni ujin dhe ta mbani atë të ngrohtë në enë termike.
- Siguroni rreth 9 litra ujë të pijshëm për person në javë.
- Siguroni një furnizim me elektrik dore, bateri, qirinj, shkrepëse dhe çakmakë nëpër shtëpi për të siguruar dritë në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike. Mos i lini qirinjtë të ndezur pa mbikëqyrje.
- Me ndihmën e një radioje me bateri ose radioje makine, mund të merrni gjithashtu informacion nga autoritetet në rast të ndërprerjes së energjisë.



- Ngrohja është e rëndësishme veçanërisht në dimër. Humbja e ngrohjes në rast ndërprerjeje të energjisë mund të kompensohet për një farë kohe me batanije të trasha, thasë gjumi dhe veshje të ngrohta.
- Nëse keni një oxhak ose sobë me dru, krijoni rezerva druri, briketa ose peleta.
- Meqenëse si pasojë e ndërprerjes së energjisë, preken edhe ATM-të mjetet elektronike të pagesës si kartat e debitit dhe të kreditit ose mundësia e pagesës me smartfon mund të dështojnë, Zyra Federale për Shërbimet Ekonomike Shtetërore rekomandon pagesën me para në dorë.
- Furnizohuni gjithashtu me sapun, letër higjienike, produkte farmaceutike për rast urgjence dhe medikamente.
- Mos harroni ushqimin për kafshët tuaja shtëpiake.

## **Çfarë duhet të marr parasysh nëse unë ose të afërmit që kanë nevojë për përkujdesje të përhershme kanë nevojë për kujdes mjekësor?**

Mbani në dispozicion ilaçe dhe produkte higjienike për një javë. Bisedoni me mjekun tuaj për furnizimin e pajisjeve elektrike si aparatet e oksigjenit ose aparate për dializë në shtëpi etj. Personat privatë që janë të varur përgjithmonë nga energjia elektrike për arsye mjekësore duhet të sqaroheni në një fazë të hershme me ekipin kantonal të menaxhimit të krizave ose spitalin më të afërt se çfarë duhet të bëjnë në rast të ndërprerjes së energjisë.

**Çfarë të bëj  
nëse afrohet  
një ndërprerje  
ciklike e  
energjisë?**

- **Informohuni paraprakisht se ku është pika më e afërt e takimit emergjent në komunitetin/lagjen tuaj.** Vendndodhjen e tyre mund ta mësoni nga administrata lokale/qyteti juaj, në vitrinat në lagje ose në [www.notfalltreffpunkt.ch](http://www.notfalltreffpunkt.ch).
- **Sigurohuni që të gjitha pajisjet elektrike që mund të përbëjnë rrezik kur ndizen përsëri** (p.sh. sobat, hekurat, etj.) janë fikur.
- **Hiqini nga priza pajisjet tuaja elektrike PARA fillimit të stakimit, në mënyrë që të mos dëmtohen kur t'i ndizni përsëri.** Kur ndodh riaktivizimi i furnizimit me energji elektrike mund të shkaktohet rritje e tensionit që mund të dëmtojë pajisjet e ndjeshme.
- **Kur të kthehet energjia elektrike, ndizni pajisjet një nga një.** Kështu shmangni rrezikun e mbingarkesës së rrjetit të energjisë elektrike.
- **Një çerek ore para fikjes së energjisë shmangni përdorimin e ashensorit.**
- **Mos parkoni në garazhe nëntokësore ose në parkingje të siguruara me barriera elektrike.** Barriera nuk do të funksionojë më nëse rryma është e stakuar.
- **Shmangni telefonatat epanevojshme gjatë stakimit të rrjetit.** Kjo do të shmangë rrezikun e mbingarkesës së rrjetit. Telefononi në numrin e urgjencës vetëm në raste urgjente. Në vend të kësaj, përdorni një radio me bateri (SRF) për të marrë informacion. Për më shumë informacione, drejtojeni pikave të takimit për emergjencat, në bashkinë tuaj.

**Cfarë duhet  
të kem  
parasysh  
gjatë stakimit  
të energjisë  
elektrike?**

# Kujdesi shtëpiak

## **A qëndrojnë të freskëta sendet e mia në frigorifer apo në ngrirje?**

Gjatë stakimit, frigoriferët dhe ngrirësit duhet të hapen sa më rrallë! Ushqimi qëndron i ftohtë ose i ngrirë për disa orë edhe kur pajisja nuk furnizohet me energji elektrike.

## **A do të furnizohem me ujë të pijshëm gjatë ndërprerjes së energjisë elektrike?**

Si rregull, furnizimi me ujë të pijshëm duhet të jetë i garantuar. Megjithatë, në shumë vende nevojiten pompa elektrike për furnizimin normal me ujë të pijshëm, të cilat duhet të funksionojnë me gjeneratorë emergjence gjatë ndërprerjes së energjisë elektrike. Prandaj, mund të mos realizohet furnizimi me ujë të pijshëm. Vini re rekomandimin për furnizime emergjente (9 litra ujë të pijshëm për person në javë) dhe përdoreni ujin me masë.

## **A funksionojnë sistemet e ujërave të zeza gjatë ndërprerjes së energjisë elektrike?**

Për pastrimin e ujërave të zeza nevojitet energji elektrike. Prandaj nuk mund të garantohet një pastrim i vazhdueshëm i ujërave të zeza. Si rrjedhojë, prodhoni sa më pak ujë të ndotur. Shpëlarja e tualetit funksionon me presion uji dhe për aq kohë sa garantohet furnizim me ujë të pijshëm.

## **A vazhdon të funksionojë gjatë ndërprerjes sistemi im ngrohës?**

Jo vetëm ngrohja elektrike, por edhe ngrohja me gaz dhe naftë, pompat e nxehtësisë dhe rrjetet e ngrohjes qendrore varen nga energjia elektrike. Prandaj, ngrohja nuk funksionon më nëse rrjeti i furnizimit me energji elektrike është stakuar.

## **Si mund të siguroj që banesa ime të qëndrojë e ngrohtë?**

Ajroseni sa më pak të jetë e mundur gjatë ndërprerjes së energjisë. Mbyllni dyert e dhomave. Mbyllni grilat dhe qepenat gjatë natës. Vishni rroba të ngrohta.

## **A funksionon sistemi im fotovoltaik kur nuk ka energji elektrike?**

Jo, nëse nuk keni një zgjidhje të vetëmjaftueshme.

## **Çfarë nuk më lejohet të bëj më?**

### **Çfarë duhet të kem parasysh?**

- Shmangni ashensorët.
- Në rast se keni derë elektrike garazhi parkojeni makinën jashtë.
- Lërini të ngritura qepenat elektrike gjatë ndërprerjes së energjisë elektrike (gjatë ditës).
- Kalojini dyert elektrike në modalitetin manual.

# Rrjeti telefonik dhe celular

## **A funksionon rrjeti telefonik dhe ai celular?**

Kudo ku ka energji elektrike, në thelb është e mundur të bësh thirrje telefonike. Transmetuesit në shtyllat e telefonisë celulare janë të pajisur me bateri, në mënyrë që sistemet të mund të vazhdojnë të punojnë për të paktën një orë në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike. Qendrat kryesore nga ku transmetohen sinjalet nga kullat e shumta të transmetimit mund të funksionojnë deri në katër orë pa energji elektrike. Ka edhe qendra qendrore të të dhënave të pajisura me sisteme energjie emergjente për të kapërcyer hendekun. Në rast të një ndërprerjeje më të gjatë të energjisë elektrike, rrjeti telefonik dhe celular mund të ndërpriten së funksionuari.

## **Si mund të bëhen thirrjet urgjente?**

Nëse telefoni celular dhe rrjeti celular nuk funksionojnë më, shkoni në një nga të ashtuquajturat pika takimi për emergjencat. Vendndodhjen e tyre mund ta gjeni nga administrata e bashkisë/komunës suaj, te vitrinat në lagje ose në [www.notfalltreffpunkt.ch](http://www.notfalltreffpunkt.ch).

Në pikën e takimit për emergjencat do të merrni informacion mbi situatën dhe mund të bëni thirrje urgjente te shërbimet e urgjencës. Mund të mësoni se kur janë të hapura pikat e takimit për emergjencat në radio ose nëpërmjet Alertswiss ([www.alert.swiss](http://www.alert.swiss) ose aplikacionit). Shkarkoni paraprakisht aplikacionin Alertswiss në smartfonin tuaj.



# Mbledhja e informacionit

## **Si mund të marr më mirë informacion?**

Mënyra më e mirë për t'u informuar është nëpërmjet radios (SRF). Merrni paraprakisht një radio me bateri (mos harroni bateritë rezervë), një radio makine ose një radio dore.

## **A vazhdon të më vijë posta?**

Sistemi postar do të ndikohej rëndë nga mungesa e energjisë. Dorëzimi i rregullt i postës nuk mund të garantohet. Prandaj duhet të merren parasysh vonesa.

## **A do vazhdojë të më vijë gazeta?**

Për shkak të sfidave logjistike dhe kufizimeve në punën gazetareske, publikimi dhe shpërndarja e medias së shkruar ditore nuk mund të garantohet.

# Furnizimet mjekësore dhe urgjencat

## **Cilat institucione mjekësore dhe kujdesi vazhdojnë të jenë funksionale?**

Rrjetet e energjisë për kujdesin bazë mjekësor në spitale, aty ku është teknikisht e mundur, përjashtohen nga mbylljet e rrjetit dhe/ose kanë zgjidhje urgjente të energjisë elektrike.

## **Çfarë duhet të marr parasysh nëse unë ose të afërmit që kanë nevojë për kujdes mjekësor apo aparaturat e mjetet ndihmëse varen nga energjia elektrike?**

Individët privatë që janë të varur përgjithmonë nga energjia elektrike për arsye mjekësore duhet të sqarojnë në një fazë të hershme me ekipin kantonal/lokal të krizave ose spitalin më të afërt se çfarë duhet të bëjnë në rast të ndërprerjes së energjisë.

## **A do t'i marr të gjitha ilaçet që më nevojiten?**

Stakimet do të njoftohen paraprakisht, ndaj ju lutemi të merrni masa paraprake dhe të mbani në dispozicion medikamentet tuaja të nevojshme në shtëpi.

## **Si të veprojmë në një rast urgjence mjekësore?**

Nëse keni nevojë për ndihmë, provoni numrat e zakonshëm të urgjencës. Nëse rrjeti telefonik nuk funksionon më, shkoni në pikën më të afërt të takimit të urgjencës ose kërkoni ndihmë nga një fqinj nëse nuk mund të arrini në pikën e takimit të urgjencës në mënyrë të pavarur. Vendndodhjet e tyre mund t'i gjeni te administrata e bashkisë/komunës suaj, te vitrinat në lagje ose [www.notfalltreffpunkt.ch](http://www.notfalltreffpunkt.ch).

## **Çfarë të bëjmë nëse ka zjarr?**

Telefonojini zjarrfikëses. Nëse rrjeti telefonik ndalon së punuari, shkoni në pikën më të afërt të takimit për emergjencat. Vendndodhjen e tyre mund ta gjeni te administrata e bashkisë/komunës suaj, te vitrinat në lagje ose në [www.notfalltreffpunkt.ch](http://www.notfalltreffpunkt.ch). Njihuni paraprakisht me trajtimin e aparateve të zjarrit, batanijeve të shuarjes së zjarrit dhe shtyllave të shuarjes me ujë (ku ndodhen ato në shtëpi? lexoni manualin e përdorimit).

# Qarkullimi rrugor dhe transporti publik

## **A mund të përdor transportin publik?**

Gjatë ndërprerjeve, transporti publik do të kufizohet shumë ose të çaktivizohet krejtësisht.

## **A do vazhdojë të funksionojë infrastruktura rrugore (semaforët, ndriçimi rrugor, vendkalimet mbi nivel, barrierat etj.)?**

Stakimet me rotacion kanë ndikim në infrastrukturën rrugore: Semaforet dhe ndriçimi rrugor nuk do të funksionojnë më, vendkalimet mbi nivel, barrierat dhe tunelet (ajrimi dhe dritat) ndikohen gjithashtu nga ndërprerja e energjisë.

## **A mund të furnizohem me karburant gjatë ndërprerjeve me rotacion?**

Jo në pikat e karburantit që ndodhen në zonat e ndërprerjes së energjisë elektrike. Furnizuesit kanë nevojë për energji elektrike për të punuar.

## **Qarkullimi ajror: A kam ende mundësi të fluturoj?**

Furnizimi me energji emergjente i aeroporteve përkatëse është subjekt i operatorëve të tyre; nëse dhe kur do jetë i mundur fluturimi, nuk mund të thuhet për momentin.

# Pazari

## **A mund të bëj pazar gjatë stakimeve me rotacion?**

Idealisht, duhet t'i keni bërë furnizimet ushqimore emergjente në mënyrë që të jeni të furnizuar gjatë ndërprerjeve të energjisë elektrike. Nëse duhet të bëni pazar gjithsesi, kini parasysh se edhe shitësit me pakicë preken nga ndërprerjet. Oraret e zakonshme të hapjes nuk mund të garantohen. Merrni me vete para të thata.

## **A mund të vazhdoj të paguaj me një kartë EC ose Twint?**

Jo, sistemet e pagesave me kartë dhe ato celulare nuk funksionojnë më. Sigurohuni që të keni gjithmonë para me vete.

## **Si mund të përballem me mungesat në shtëpi?**

Para se të bëni pazar, shikoni ofertat e mundshme të shkëmbimit në lagje me fqinjët dhe me miqtë. Gjithashtu jini sa më solidarë me fqinjët dhe të moshuarit që nuk lëvizin dot. Ndhmoni njëri-tjetrin.

# Puna dhe shkolla

## **A duhet të shkoj në punë gjatë ndërprerjeve të energjisë elektrike?**

Sqaroni paraprakisht me punëdhënësin tuaj se çfarë vlen në kompaninë tuaj.

## **A do të mbyllen shkollat gjatë stakimeve me rotacion?**

Sistemi shkollor do të vazhdojë të funksionojë sa më gjatë të jetë e mundur.

**Faqe  
interneti dhe  
informacione  
të dobishme**

**Informacion mbi situatën aktuale të furnizimit:  
Paneli i Energjisë i Zyrës Federale të Energjisë**  
[energiedashboard.admin.ch/dashboard](https://energiedashboard.admin.ch/dashboard)

**Informacioni aktual mbi sigurinë e furnizimit me energji  
elektrike**  
[elcom.admin.ch](https://elcom.admin.ch) → **Versorgungssicherheit**

**Zyra Federale për Ekonominë dhe Furnizimin Krahinor**  
[bwl.admin.ch](https://bwl.admin.ch)

**Uebajti dhe aplikacioni Alertswiss**  
[alert.swiss/de](https://alert.swiss/de)

**Pikë takimi për emergjencat**  
[notfalltreffpunkt.ch](https://notfalltreffpunkt.ch)

**Organizim për energji elektrike në lokacione të  
jashtëzakonshme OSTRAL**  
[ostral.ch](https://ostral.ch)

**Filmi shpjegues "In Kürze: Das Risiko einer Strom-  
mangellage"**  
[ostral.ch](https://ostral.ch)

**Faqja e fushatës "Mos u zhduk"**  
[nicht-verschwenden.ch](https://nicht-verschwenden.ch)  
**Hotline 0848 444 444**

Kjo broshurë është hartuar me kujdesin më të madh. Megjithatë, nuk mund të merret përsipër asnjë garanci ose përgjegjësi për saktësinë, plotësinë dhe aktualitetin e përmbajtjes.  
Version 1.1, Janar 2024

# Lista e furnizimit



## **Pije dhe ushqime**

- 9 litra ujë të pijshëm për person në javë
- Oriz, prodhime brumi, bollgur, fruta të thata etj.
- Ushqim i konservuar me perime, kërpudha dhe fruta
- Ushqime të gatshme (p.sh. Rosti ose supë e gatshme)
- Mish i thatë dhe produkte peshku
- Peksimadhe ose bukë e freskët
- Musli, fruta të thata, arra
- Djathë i fortë, djathë i shkrirë
- Miell, maja e thatë
- Sheqer, kripë, piper, lëng mishi, vaj ose yndyrna të tjera
- Reçel, mjaltë, çokollatë
- Qumësht UHT, qumësht i kondensuar
- Kafe, kakao dhe çaj
- Ushqime të veçanta (p.sh. ushqim për fëmijë ose të përshtatshme për intolerancat ushqimore)

## **Medikamente shtëpiake dhe produkte higjienë**

- Sapun, dezinfektues, maska higjienike
- Letër higjienike
- Medikamente personale

## **Teknologji**

- Radio me bateri duke përfshirë bateri rezervë, radio dore
- Elektrik dore përfshirë bateri rezervë
- Qirinj, shkrepëse, çakmakë
- Tenxhere me gaz, Fondue-Rechaud, skarë
- Karikues rezervë

## **Të tjera**

- Para të thata
- Ushqim për kafshët shtëpiake